

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2014

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme në tregun e hapur (në milionë lekë*).

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore	R/REPO tremujore
02.10.2014		28,800.00	2,000.00	
09.10.2014		27,170.00	2,000.00	
16.10.2014		26,690.00	2,000.00	
17.10.2014	1,350.00			
23.10.2014		31,300.00	2,400.00	
30.10.2014		30,700.00	2,000.00	
06.11.2014		24,000.00	3,000.00	
13.11.2014		27,100.00	3,000.00	
20.11.2014		23,580.00	2,600.00	
27.11.2014		27,600.00	3,000.00	
04.12.2014		21,700.00	3,000.00	2,000.00
11.12.2014		12,600.00	2,650.00	1,700.00
18.12.2014		11,530.00	2,100.00	
22.12.2014	700.00			
23.12.2014	840.00			
26.12.2014		15,130.00	2,100.00	

23.68 miliardë lekë në javë*, shoqëruar njëkohësisht me marrëveshje të anasjelltë riblerjeje me maturim njëmujor, mesatarisht 2.45 miliardë lekë në javë*. Ndërkohë, në dy javët e para të muajit dhjetor është përdorur edhe marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim tremujor, mesatarisht për 1.85 miliardë lekë për ankand*. Operacionet injektuese njëditore janë përdorur në tre raste, në datë 17 tetor, me qëllim korrigjimin e sasisë së likuiditetit në sistem për efekt të devijimit në kah negativ të faktorëve si dhe në datat 22-23 dhjetor, që përkojnë me fundin e periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar, pas mosplotësimit të ankandit injektues njëjavor të radhës.

Edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit është vijuar me operacionet për shitblerje me të drejta të plota, duke synuar uljen e zotërimit të BSh-së në bono thesari në jo më shumë se niveli 70% i totalit të çdo emetimi. Në tremujorin e fundit janë realizuar tre ankande për shitje me të drejta të plota të bonove 6-mujore me maturim në janar 2015 dhe shkurt 2015, duke ulur zotërimin e BSh-së në këto letra në total për 220 milionë lekë, ndërkohë që u zhvillua edhe një ankand për blerje bono thesari 12-mujore të sapoemetuara me shumë të shpallur 100 milionë lekë. Portofoli i BSh-së në fund të vitit 2014 rezulton të jetë 35 milionë lekë më i ulët se një vit më parë.

* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

1.1. Operacione të tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të fundit të vitit 2014 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim të përkohshëm të likuiditetit dhe operacione të përhershme me qëllim strukturimin e portofolit të BSH-së.

Sasia totale e likuiditetit të injektuar ka rezultuar mesatarisht 28.21 miliardë lekë, duke qëndruar pranë nivelit prej 28.06 miliardë lekësh të regjistruar në tremujorin e tretë të vitit 2014. Likuiditeti mesatar i injektuar rezulton rreth 76% më i lartë se 1 vit më parë, kur kjo vlerë ishte rreth 16.05 mld lekë.

Për injektimin e likuiditetit të përkohshëm në tremujorin e fundit të vitit, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht


1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Depozita njëditore është përdorur në 35 raste, mesatarisht për 5.39 miliardë lekë, kundrejt 27 rasteve në tremujorin e kaluar, ekuivalente me kthim likuiditeti në BSH për 2.07 mld lekë në ditë.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 2 raste, në datat 23 tetor dhe 23 dhjetor, që përkojnë me fundin e periudhës së mbajtjes së rezervës, për shumën, respektivisht, 1.95 mld lekë dhe 2.39 mld lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2011-2014.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, në periudhën 2011-2014 (me çmim blerjeje).




2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2014

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, Banka e Shqipërisë ka publikuar kalendarin e ankandeve për blerjen e valutës për një periudhë 12-mujore me synim rritjen e rezervës së saj valutore. Në kalendar u publikua organizimi i tre ankandeve për blerjen e 2-5 milionë euro, nga të cilët i pari u organizua në muajin dhjetor 2014, ndërsa dy të tjerë do të organizohen në prill 2015 dhe korrik 2015.

Në ankandin e organizuar në datën 11 dhjetor dhe me anë të marrëveshjeve shtesë të lidhura pas tij, Banka e Shqipërisë bleu në total 10.3 milionë euro.

Grafik 2: Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e katërt të vitit 2014.



2.2 Veprime me institucione të tjera

Në tremujorin e fundit të vitit kanë rifilluar marrëveshjet *swap* midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të kësaj të fundit, që synojnë menaxhimin e likuiditetit të saj. Si rezultat i tyre, blerjet e valutës së BSh nga MF qenë 28,014.20 milionë lekë dhe shitjet 28,055.88 milionë lekë. Në mbyllje të tremujorit, marrëveshjet e pamaturuara *swap* qenë 120 milionë euro.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 345.05 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

Tabelë 2: Veprime valutore me institucione të tjera.

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCEVE	28,014.20	28,055.88
TË TJERA (IDA, IBRD)	345.05	